

AKT THEMELIMI DHE STATUT : **"MEET GROUP" SHPK**

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"MEET GROUP" SHPK

AKT THEMELIMI DHE STATUT **"MEET GROUP" SHPK**



**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQËRISË ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"MEET GROUP" SHPK**

EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE

NENI 1 - EMRI I SHOQËRISË

- 1.1. Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **"MEET GROUP"** SHPK (me poshtë e quajtur "Shoqëria"). Shoqëria do të nënshtrohet Legjislacionit Shqiptar , ndërsa degët që mund të krijohen do të nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega . Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues .

NENI 2 - FORMA LIGJORE

- 2.1. Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregëtar në Shqipëri.
- 2.2. Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.

NENI 3- THEMELIMI - KOHËZGJATJA

- 3.1. Shoqëria u themelua sot më date 25.09.2023. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar.

NENI 4 - BAZA LIGJORE

- 4.1. Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Akt Themelimi dhe Statut, legjislacionin tregëtar dhe dispozitat e tjera ligjore në fuqi.
- 4.2. Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut, do të aplikohen dispozitat e ligjit nr. 9901, date 14.04.2008. "Për tregtarët dhe shogeritë tregëtarë", i ndryshuar.
- 4.3. Cdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me zbatimin dhe/ose interpretimin e këtij Statuti, do të zgjidhet nga gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 5 - PERSONALITETI JURIDIK. KOHËZGJATJA

- 5.1. Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregëtar pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit, Shqipëri.
- 5.2. Afati i veprimtarisë së shoqërisë është i pakufizuar.

NENI 6 - SELIA

- 6.1. Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Lagjia "Granice", Rruga "Vangjel Koca", objekti me nr. Pasurie 30/283, zona kadastrale 8541, Gjirokastrë, Shqipëri.
- 6.2. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj , të hapë zyra përfaqësie, degë , të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakut të vetëm .

NENI 7 - EMBLEMA. VULA

- 7.1. Shoqëria do të ketë emblemën dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.
- 7.2. Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e Legjislacionit Shqiptar.
- 7.3. Te gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përmbajnë emblemën dhe vulën e saj.

NENI 8 - OBJEKTI I SHOQËRISË

- 8.1. Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht në:

Cdo aktivitet ne lidhje me Ndertimin dhe Konstruksionin (si projektim, hartim , vleresim,administrim, sherbim etj... ne kete fushe) Konsulence ne fushen e ndertimit Import - Eksport mallrash. Dhenie makinash me qera si dhe cdo lloj aktiviteti tjetër ne lidhje me te. Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjetër i cili është në përputhje me Ligjet e Republikës së Shqipërisë. Mund të marrë pjesë dhe të jetë e interesuar në shoqëri apo sipërmarrje, shqiptare apo të huaja, që kryejnë aktivitete të njëjta apo të ngjashme si dhe të lidhura me aktivitetin e saj ose te subjekteve pjesëmarrëse; Mund te lidhë kontrata shitblerje, përdorimi, shkëmbimi, sipërmarrje apo marrëveshje të tjera me kliente, investitorë, bashke-investitorë, operatorë dhe administrues të strukturave turistike; Mund të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme ose të dobishme ose që kanë të bëjnë, përfshirë por pa u kufizuar në: ofrimin e garancive reale dhe/ose personale për detyrimet e veta dhe të tretëve, veprime me pasuri të luajtshme, te paluajtshme, tregtare apo veprim tjetër që ka të bëjë me objektin e saj ose që mundëson një përdorim me të mire të strukturave dhe/ose burimeve nëpërmjet shoqërive ose sipërmarrjeve në të cilat, direkt apo indirekt, Shoqëria ka pjesëmarrje apo kontrollin e tyre.

- 8.2. Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë saj , të kryejë cdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës me qëllim që te përmbushë ose te jetë i dobishëm për përmbushjen e objektit ta saj.

NENI 9 - KAPITALI THEMELTAR

- 9.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100.000 Leke (leke). Kapitali eshte 100% nga kuotat e ortakut te vetem, e ndare ne 1 kuote . Kapitali themeltar fillestar mund te shtohet ose te pakesohet (por jo nen vleren e kapitalit themeltar fillestar).

- **Z.Mehmet Çağlak** shtetas turk, i lindur në Kumru, Turqi, më 15.09.1997, identifikuar me nr. personal A14P17609, dhe nr. Pasaporte U25156999 i cili zotëron 100 % (njëqind për qind te kapitalit)

- 9.2. Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë, ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit te kapitalit në përpjesetim të drejtë me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin e Shoqërisë.

9.3. Kapitali është shlyer tërësisht.

9.4 Përgjegjësia e Ortakëve shtrihet deri ne vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

NENI 10 - TRANSFERIMI I KUOTAVE. KUFIZIMET

- 10.1 Kuota e kapitalit është e transferueshme dhe mund të transferohet në cdo moment sipas kushteve dhe afateve të parashikuara nga ligji shqiptar.
- 10.2 Vendosja e çfarëdo lloj barre mbi pjesët e kapitalit në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Asamblesë së Ortakëve.

NENI 11 - ORTAKËT THEMELUES

- 11.1 Shoqeria "MEET GROUP" SHPK themelohet nga Ortaku I vetëm:
- **Z.Mehmet Çağlak** shtetas turk, i lindur në Kumru, Turqi, më 15.09.1997, identifikuar me nr. personal A14P17609, dhe nr. Pasaporte U25156999, i cili zotëron 100 % (njëqind për qind të kapitalit)

ORGANET E SHOQËRISË

NENI 12 - VENDIMET E ASAMBLESE SË ORTAKËVE

- 12.1 Asambleja e Ortakëve në përputhje me legjislacionin shqiptar, mund të vendosë, por pa u kufizuar në to, vendimet më poshtë:
- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre nga administratori ose administratorët, përfshi raportet financiare;
 - zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - miratimin e shkrirjes/bashkimit me shoqëri të tjera; ndryshimin e statutit të shoqërisë;
 - ndryshimin e selisë dhe të emërimit të shoqërisë;
 - emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar, në qoftë se është e nevojshme;
 - rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;

- shitjen ose transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar palëve të treta;
- ristrukturimin dhe prishjen shoqërisë;
- emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë;
- miratimin e pasqyrave financiare të shoqërisë dhe raportit të administratorit(ëve);
- vendimin për shpërndarjen e fitimit dhe mbulimin e humbjeve transformimin e shoqërisë në forma të tjera;
- dhe cdo lëndë tjetër të parashikuar nga statuti ose nga ligji.

NENI 13 - ADMINISTRIMI

- 13.1 Administrimi i shoqërisë do të kryhet nga një ose më shumë administratorë që emërohen me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Në rast se Shoqëria do të administrohet nga më shumë se një administrator, atëherë Administratorët mund ti ushtrojnë kompetencat bashkarisht ose vecmas sikurse do të përcaktohet në vendimin përkatës të Asamblesë së Ortakëve.
- 13.2 Administratori i parë i shoqërisë është:
- **Z. Z.Mehmet Çağlak** shtetas turk, i lindur në Kumru, Turqi, më 15.09.1997, identifikuar me nr. personal A14P17609, dhe nr. Pasaporte U25156999. Afati i emërimit të administratorit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.
- 13.3 Administratorëve u jepen të gjitha kompetencat e përcaktuara nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në to, Administratorët janë përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:
- drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
 - përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose me përfaqësim;
 - hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit;
 - përgatitjen e dokumenteve në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zotëron;
 - të lidhë kontrata për dhe në emër të shoqërisë me palë të treta, të puësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet i nevojshëm për mbarëvajtjen e aktivitetit të shoqërisë;
 - të përfaqësojë shoqërinë përpara bankave të nivelit të dytë dhe Bankës së Shqipërisë si dhe të kryejë cdo transaksion bankar në emër të shoqërisë;
 - të ndërmarrë cdo veprimtari tjetër, ose biznes, ose aktivitet i cili konsiderohet i nevojshëm për administrimin efikas të Shoqërisë në Shqipëri.
- 13.4 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për pesë vjet me të drejtë ripërtëritje ose deri në castin e revokimit të tij me vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- 13.5 Administratori i Shoqërisë mund ti transferojë cdo personi apo grupi personash të gjitha apo një pjesë të kompetencave të tij sipas këtij Statuti dhe me kushtet që ai konsideron si të arsyeshme dhe në cdo kohë mund të anullojë këtë transferim kompetencash.

NENI 14 - VITI FINANCIAR

- 14.1 Viti financiar i shoqërisë përpunet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe përfundon më 31 Dhjetor të cdo viti.
- 14.2 Përfundimisht, viti i parë financiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

NENI 15 - BILANCI. KONTABILITETI.

- 15.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore dhe Qendrës Kombëtare të Regjistrimit
- 15.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislacionit përkatës. Për operacione të vecanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me Hogan të vecanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.
- 15.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.



NENI 16 - TË ARDHURAT, DIVIDENDI

- 16.1 Shoqëria mund të krijojë fonde rezerve për realizimin e qëllimeve të aktivitetit të saj në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901. datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 16.2 Fitimet që do të rrezultojnë në fund të mbylljes së cdo viti ushtrimor, pas pagimit të tatimeve, mund të ndahen nga Asambleja e Ortakëve.
- 16.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe cdo ortak do të përgjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

NENI 17 — LIKUIDIMI

- 17.1. Likuidimi e Shoqërisë si dhe emërimi i likuidatorit(eve) bëhet në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe cdo ligj tjetër të zbatueshëm.

NENI 18 — MOSMARRËVESHJET

- 18.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do të nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

NENI 19 – KLAUZOLË MBYLLËSE

- 19.1 Ky Statut hartohet në 3 (tre) ekzemplarë me fuqi të njëjtë ligjore. Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortaku i vetëm .

**Ortak i vetëm themelues i "MEET GROUP" SHPK
Z.MEHMET ÇAĞLAK**

mehmet ÇAĞLAK


